



Standardi Global i IUCN-së për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra

Korniza lehtësisht e përdorshme për verifikimin,
hartimin dhe shkallëzimin e Zgjidhjeve të
Mbështetura tek Natyra

Botimi i parë



UNIONI NDËRKOMBËTAR PËR RUAJTJEN E NATYRËS



Rreth IUCN-së

IUCN-ja është Unioni i cili në përbërjen e tij unike përmban anëtarësimin e organizatave qeveritare dhe të shoqërisë civile. Përmes tij organizatat publike, private dhe joqeveritare arrijnë të përftojnë njohuri dhe mjete, të cilat bëjnë të mundur realizimin e përbashkët të progresit të njeriut, zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes së natyrës.

IUCN-ja u krijua më 1948 dhe tashmë është rrjeti më i madh dhe më i larmishëm në rang botëror për mjedisin, i cili përdor njohuritë, burimet dhe kapacitetet e më shumë se 1 400 organizatave anëtare dhe afërsisht 15 000 ekspertëve. Ai është ofruesi kryesor i të dhënave, vlerësimeve dhe analizimeve për ruajtjen. Anëtarësia e tij e madhe i jep mundësinë IUCN-së të kryejë rolin e inkubatorit dhe depozituesit të besuar të praktikave më të mira, mjeteve dhe standardeve ndërkombëtare.

IUCN-ja siguron një hapësirë neutrale në të cilën aktorë të ndryshëm përfshirë qeveritë, OJQ-të, shkencëtarët, bizneset, komunitetet lokale, organizatat e popujve autoktonë dhe të tjerë, mund të punojnë së bashku për të krijuar dhe zbatuar zgjidhjet ndaj sfidave mjedisore dhe për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm.

Përmes bashkëpunimit dhe mbështetjes së organizatave partnere, IUCN-ja ka realizuar një paketë të gjerë e të larmishme projektesh mbarëbotërore për ruajtjen. Ndërturja e shkencës më të fundit me njohuritë tradicionale të komuniteteve lokale, kanë bërë të mundur që këto projekte të përqendrohen në shmangien e humbjes së habitateve, restaurimin e ekosistemeve dhe përmirësimin e mirëqenies së njeriut.

www.iucn.org

<https://twitter.com/IUCN/>

Standardi Global i IUCN-së për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra

Korniza lehtësisht e përdorshme për verifikimin, hartimin dhe shkallëzimin e Zgjidhjeve të Mbështetura tek Natyra

Botimi i parë

Përcaktimi i enteve gjeografike në këtë libër, dhe paraqitja e materialit, nuk nënkuptojnë shprehjen e ndonjë opinioni të çfarëdoshëm nga ana e IUCN-së apo organizatave pjesëmarrëse në lidhje me statusin ligjor të ndonjë vendi, territori ose zone, apo të autoriteteve të saj, apo në lidhje me përcaktimin e kufijve ose juridiksioneve.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë doemos ato të IUCN-së apo të organizatave të tjera pjesëmarrëse.

IUCN-ja përfiton nga rasti të falënderojë për mbështetjen e tyre Partnerët e Kornizës të cilët ofruan financimin kryesor: Ministrinë e Punëve të Jashtme të Danimarkës; Ministrinë e Punëve të Jashtme të Finlandës; Qeverinë e Francës dhe Agjencinë Franceze për Zhvillim (AFD); Ministrinë e Mjedisit të Republikës së Koresë; Agjencinë Norvegjeze për Bashkëpunimin për Zhvillim (Norad); Agjencinë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida); Agjencinë Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Departamentin Amerikan të Shtetit.

IUCN-ja dhe organizatat e tjera pjesëmarrëse nuk mbajnë asnjë përgjegjësi për ndonjë gabim apo heqje fjale e cila mund të jetë shfaqur gjatë procesit të përkthimit në gjuhën shqipe të këtij dokumenti, versioni origjinal i të cilit është në gjuhën angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, ju lutemi referojuni botimit në gjuhën origjinale. Titulli origjinal i botimit: *Global Standard for Nature-based Solutions. A user-friendly framework for the verification, design and scaling up of NbS*. First edition. (2020). Botuar nga: IUCN, Gland, Zvicër. DOI: <https://doi.org/10.2305/IUCN.CH.2020.08.en>

Standardi Global për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra shoqërohet nga *Udhëzuesi për përdorimin e Standardit Global të IUCN-së për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra* (<https://doi.org/10.2305/IUCN.CH.2020.09.sq>), i cili ofron bazën shkencore dhe udhëzuesin për përdoruesit.

Ky botim është mundësuar pjesërisht nga financimi i Grupit të Agjencisë Franceze për Zhvillim (AFD), përmes Partneritetit për Zhvillimin e Natyrës Francë-IUCN.

Botuar nga:	IUCN, Gland, Zvicër
E drejta e autorit:	© 2020 IUCN, Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës dhe Burimeve Natyrore © 2021 Zyra Rajonale për Europën Lindore dhe Azinë Qendrore e IUCN-së, për përkthimin në gjuhën shqipe Riprodhimi i këtij botimi për qëllime arsimore apo qëllime të tjera jotregtare, është i autorizuar pa pasur nevojën e marrjes së lejes me shkrim nga mbajtësi i të drejtës së autorit me kusht që burimi të bëhet i njohur plotësisht. Riprodhimi i këtij botimi për rishitje apo qëllime të tjera tregtare është i ndaluar nëse nuk merret paraprakisht leja me shkrim nga mbajtësi i të drejtës së autorit.
Citimi:	IUCN (2021). <i>Standardi Global për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra. Komiza lehtësisht e përdorshme për verifikimin, hartimin dhe shkallëzimin e ZMN-ve</i> . Botimi i parë. Gland, Zvicër: IUCN.
ISBN:	978-2-8317-2107-1 (PDF) 978-2-8317-2108-8 (print)
DOI:	https://doi.org/10.2305/IUCN.CH.2020.08.sq
Përkthyer nga:	Iris Klosi
Ilustrimi i kopertinës:	Përcaktimi i Zgjidhjeve të Mbështetura tek Natyra © IUCN
Faqosja nga:	Imre Sebestyén jr/Unit Graphics
Përgatitur për botim nga:	GRAFIK CENTAR d.o.o.
Ofrohet nga:	IUCN, Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës Grupi për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra Rue Mauverney 28 1196 Gland, Zvicër NbSStandard@iucn.org www.iucn.org/resources/publications

Teksti i këtij botimi është shtypur në letër të prodhuar nga fibra druri të pyjeve të certifikuar në përputhje me rregullat e Këshillit të Administrimit të Pyjeve (KAP).

Tabela e përmbajtjes

Historiku i dokumenteve	v
Standardi Global për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra	1
Hyrje	1
Sfondi historik	1
Pse duhet Standardi?	2
Çfarë bën Standardi?	2
Kush mund ta përdorë Standardin?	3
Si duket Standardi?	3
Si mund të përdoret Standardi?	4
Sigurimi i një Standardi Global të qëndrueshëm për ZMN-të	4
Kriteri 1: ZMN-të adresojnë sfidat shoqërore në mënyrë të efektshme	6
Sfidat shoqërore:	7
Rast studimor: Identifikimi i një sfide shoqërore	7
Kriteri 2: Hartimi i ZMN-ve informohet në bazë të shkallës	8
Hartimi duke pasur parasysh metodën e shkallëzimit	9
Rast studimor: Hartimi duke pasur parasysh metodën e shkallëzimit – Kombinimi i ZMN-ve me infrastrukturën e ujërave për zgjidhjet me anë të metodës së shkallëzimit	9
Kriteri 3: ZMN-të rezultojnë në përfitimin e integritetit të biodiversitetit dhe ekosistemit	10
Përfitimi i biodiversitetit	11
Rast studimor: Demonstrimi i përfitimeve të biodiversitetit: Riharmonizimi bregdetar në shkallë të gjerë duke përdorur ZMN-të mund të (ri)krijojë habitatet e biodiversitetit	11
Kriteri 4: ZMN-të janë ekonomikisht të realizueshme	12

Realizueshmëria nga ana ekonomike	13
Rast studimor: Menaxhimi i ekosistemit bregdetar si ZMN për krizat klimatike	13
Kriteri 5: ZMN-të bazohen në procese qeverisëse gjithëpërfshirëse, transparente dhe fuqizuese	14
Qeverisja gjithëpërfshirëse	15
Rast studimor: Planifikimi dhe zbatimi bashkëpunues i ZMN-ve urbane në Sint-Andries	15
Kriteri 6: ZMN-të balancojnë në mënyrë të barabartë kompromiset për përmbushjen e qëllimit(ve) të tyre kryesor dhe sigurimit të vazhdueshëm të përfitimeve të shumta	16
Balancimi i kompromiseve	17
Rast studimor: Gjetja e mangësive nga të cilat mund të nxirret mësim – siguri i ushqimit dhe ruajtja e peshkut në Bangladesh	17
Kriteri 7: ZMN-të menaxhohen në mënyrë të përshtatur, duke u bazuar në fakte	18
Menaxhimi i përshtatur	19
Rast studimor: Shinianga	19
Kriteri 8: ZMN-të janë të qëndrueshme dhe të integruara brenda kontekstit të duhur territorial	20
Integrimi dhe qëndrueshmëria	21
Rast studimor: Sfidat e Bonn-it të El-Salvadorit	21

Historiku i dokumenteve

Standardi Global i IUCN-së për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra	
Botimi	1.0
Gjuha e tekstit origjinal	Angleze. Përkthimet zyrtare të disponueshme.
Njësia Përgjegjëse	Programi Global i Menaxhimit të Ekosistemit; Komisioni i IUCN-së për Menaxhimin e Ekosistemit
Zhvilluar nga	Grupi i IUCN-së për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra; Komisioni i IUCN-së për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra
Lënda (Taksonomi)	Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra; Standardi; Menaxhimi i Ekosistemit; Efektshmëria e Menaxhimit; Sigurimi
Data e miratimit	Shkurt 2020
Miraturar nga	Këshilli i IUCN-së
Objekti	Të ofrojë udhëzime dhe një kornizë globale për hartimin, verifikimin dhe shkallëzimin e Zgjidhjeve të Mbështetura tek Natyra. Standardi përfshin Kriteria dhe Tregues të qëndrueshëm në rang global, të cilët mbështeten nga Parimet për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra, për të matur nivelin e ndërhyrjeve.
Është pjesë e	Grupit të IUCN-së për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra
Është në përputhje me	Sistemin e Menaxhimit Mjedisor dhe Shoqëror (ESMS) [SMMSH] të IUCN-së Kodi i Praktikave të Mira për Vendorsjen e Standardeve të ISEAL-it
Dokumente shoqëruese	Dokumenti i Sfondit Historik të Standardit Global për Standardin Global të IUCN-së për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra
Distributori	IUCN COMPASS; Portali i Unionit të IUCN-së dhe faqja e internetit të IUCN-së

Historiku i Dokumenteve		Botimi i parë aktual
Versioni	Data e Publikimit	Përmbledhje e Ndryshimeve
0.1	Tetor 2018	Diskutimet e brendshme u realizuan me Anëtarët e IUCN-së, Komisionet dhe Sekretariatit.
0.2	Dhjetor 2018	Redaktimet e kryera nga reagimi i brendshëm dhe versioni i ri i paraqitur në konsultimin e parë publik i cili zgjati një muaj.
0.3	Janar 2019	Redaktimet kryesore të kryera nga reagimi i jashtëm dhe versioni i ri i paraqitur në konsultimin e dytë publik i cili zgjati dy muaj.
0.4	Shkurt 2020	Redaktimet e kryera në përputhje me reagimin nga konsultimi i dytë publik e më pas të pranuar nga Këshilli i IUCN-së, i cili e miratoi publikimin e tij gjatë Takimit të 98-të në Selinë Botërore të IUCN-së në Gland të Zvicrës.
0.5	Mars 2020	Recensimi i kryer nga recensues të jashtëm.

Standardi Global për Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra

Hyrje

Sfondi historik

Për pjesën më të madhe të shekullit të 20-të, vendimmarrësit e trajtonin ruajtjen e natyrës si çështje dytësore në agjendat kombëtare dhe globale. Në rastin më të mirë, ajo konsiderohej si një interes me vlerë, në rastin më të keq, një pengesë për zhvillimin. Megjithatë, rritja e numrit të marrëveshjeve shkencore tregon se pikëpamje të tilla ishin të gabuara dhe se “natyra është thelbësore për ekzistencën e njeriut dhe cilësinë e mirë të jetës”. Mosnjohja e këtij fakti jo vetëm që krijon një model negativ për zhvillimin ekonomik, i cili dëmton ekonominë e ardhshme dhe shkakon humbjen masive të biodiversitetit, por gjithashtu nuk krijon mundësinë për të përdorur natyrën në mënyrë të efektshme për të ndihmuar në zgjidhjen e sfidave kryesore shoqërore të tilla si ndryshimet klimatike, shëndeti i njeriut, sigurimi i ushqimit, zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë.

Përdorimi i qëndrueshëm i kapitalit natyror, që nënkupton rezervat botërore të pasurive natyrore të cilat përfshijnë gjeologjinë, tokën, ajrin, ujin dhe gjallesat, luan një rol të rëndësishëm në përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara. Për vite me radhë, IUCN-ja ka ndërmarrë iniciativa novatore për ruajtjen, të cilat në të njëjtën kohë kanë ndihmuar për të mbrojtur, menaxhuar dhe restauruar mjedisin, duke sjellë përfitime konkrete dhe të qëndrueshme për njerëzit. Kjo lloj qasjeje tashmë njihet gjerësisht si Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra (Figura 1). Në bazë të dokumenteve të ndryshme është provuar se Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra (ZMN), të tilla si mbrojtja e pellgut ujëmbledhës, mund të sigurojnë të ardhura për komunitetet lokale si dhe përfitime për njësitë e qeverisjes vendore të cilat varen nga këto burime për shëndetin dhe mirëqenien e tyre. Tashmë ka të dhëna të



© IUCN

Figura 1 “Zgjidhjet e Mbështetura tek Natyra janë veprime për të mbrojtur, menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme dhe restauruar ekosistemet natyrore apo të modifikuara, të cilat i adresojnë sfidat shoqërore në mënyrë të efektshme dhe të përshtatshme, për të siguruar si mirëqenien e njeriut ashtu dhe përfitimet e biodiversitetit.” (IUCN, 2016)

pakundërshtueshme të cilat tregojnë se natyra luan një rol të rëndësishëm në përmbushjen e nevojave tona shoqërore, që nga investimi për restaurimin e tokave të degraduara dhe brigjeve bregdetare e deri tek optimizimi i performancës së infrastrukturës tradicionale, të tilla si digat dhe pritat.

IUCN-ja shpreh bindjen se integrimi i ruajtjes së natyrës në sektorët kryesorë të ekonomisë është thelbësor. Gjithashtu, si qeveritë ashtu edhe bizneset e pranojnë se ZMN-të nuk janë vetëm mjete të dobishme, por edhe të domosdoshme për të adresuar krizat e dyfishta globale të humbjes së biodiversitetit dhe ndryshimeve klimatike.

Kërkimet nxjerrin në pah se ZMN-të mund të ofrojnë rreth 30% të zbutjes me kosto të efektshme, e cila nevojitet deri në vitin 2030 për të stabilizuar ngrohjen nën 2°C. Ato mund të ofrojnë gjithashtu edhe mbrojtje të qëndrueshme kundrejt ndikimeve dhe rreziqeve afatgjata të ndryshimeve klimatike, të cilat janë kërcënimet më të mëdha për biodiversitetin. Gjetja e mënyrave për të punuar me ekosistemet, në krahasim me mbështetjen vetëm tek zgjidhjet inxhinierike tradicionale, mund t'i ndihmojë komunitetet të përshtaten me ndikimet që vijnë si pasojë e ndryshimeve klimatike. Përdorimi i natyrës në qytetet e gjelbra mund të sigurojë gjithashtu kursimin e dukshëm të energjisë dhe përfitime shëndetësore.

Shumë vende tashmë po ndërmarrin veprime për përfshirjen e ZMN-ve në strategitë e tyre kombëtare për klimën, e cila është edhe arsyeja se përse këto veprime duhet të zhvillohen dhe zbatohen në bazë të kriterëve dhe praktikave më të mira të disponueshme. Për t'i ardhur në ndihmë drejtimit të kësaj qasjeje, IUCN-ja hodhi idenë për përkufizimin e parë global të ZMN-ve në vitin 2016. Ato janë "Veprime për të mbrojtur, menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme dhe restauruar ekosistemet natyrore apo të modifikuara, të cilat i adresojnë sfidat shoqërore në mënyrë të efektshme dhe të përshtatshme, për të siguruar si mirëqenien e njeriut ashtu dhe përfitimet e biodiversitetit".

Bazat themelore të ZMN-ve rrjedhin nga praktikat e krijuara të tilla si restaurimi i peizazhit pyjor, menaxhimi i integruar i burimeve ujore, përshtatja dhe zbutja e mbështetur tek ekosistemi dhe zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë duke u mbështetur tek ekosistemi, disa prej të cilave u zhvilluan dhe u bënë publike për herë të parë nga IUCN-ja në fund të viteve 1990 dhe 2000. Që atëherë, qeveritë, bizneset, akademia dhe aktorët joqeveritarë kanë vazhduar të demonstrojnë vlerën e tyre.

Ditët e sotme, ZMN-të konsiderohen nga një sërë aktorësh si mekanizmi kryesor për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm. Standardi Global i IUCN-së për Zgjidhjet e të Mbështetura tek Natyra synon të sigurojë që zbatimi i kësaj qasjeje të jetë i besueshëm, dhe përdorimi i saj të gjurmohet dhe matet për menaxhimin e përshtatur, në mënyrë që kontributet e saj të mund të arrijnë t'i frymëzojnë të tjerët. Për ta çuar më tej këtë nismë, do të kërkohet rigorozitet shkencor, kërkim akademik, qeverisje e mirë dhe mbi të gjitha, vullnet nga ana e palëve të ndryshme për të ndihmuar në integrimin e Standardit, dhe për rrjedhojë për të ndihmuar në zhvillimin e tij si mjetin kryesor për ruajtjen dhe zhvillimin së bashku.

Pse duhet Standardi?

Kur ZMN-të bëhen pjesë e politikave dhe miratohen nga projektet në terren, lind nevoja e ngutshme për më shumë qartësi dhe saktësi të përkufizimit të konceptit dhe asaj që kërkohet për ta përdorur me sukses. Në mungesë të këtyre të fundit, zbatimi i ZMN-ve mund të çojë në zbatime të paqëndrueshme dhe të pabaza. Standardi, për rrjedhojë, ofron gjithashtu një kornizë të të nxëniet sistematik, në mënyrë që mësimet të mund të përmirësohen dhe të zhvillojnë zbatimet, duke krijuar në këtë mënyrë besueshmëri më të madhe ndër radhët e vendimmarrësve për ZMN-të. Po ashtu, në mungesë të një Standardi të tillë, ZMN-të mund të mbeten një koncept i përgjithshëm, duke pasur kufizime për kontributin ndaj nevojave të ngutshme të qëndrueshmërisë dhe duke mos arritur të shpalosin të gjithë potencialin e tyre. Për rrjedhojë, Standardi ofron mundësinë për të krijuar një komunitet global përdoruesish, të cilët ndihmojnë për ta zbatuar atë në terren, përshpejtojnë zhvillimin e politikave dhe krijojnë shkencën për ruajtjen e ZMN-ve. Përmes Standardit, ZMN-të do të bazohen në kuptimin dhe vizionin e përbashkët të interpretimit të tyre për një botë të drejtë e të qëndrueshme.

Çfarë bën Standardi?

Standardi ka për qëllim t'i pajisë përdoruesit me një kornizë të qëndrueshme për hartimin dhe verifikimin e ZMN-ve të cilat sigurojnë rezultatet e dëshiruara, duke zgjidhur një ose disa sfida shoqërore. Në bazë të reagimit të përdoruesve aktualë dhe të mundshëm të ZMN-ve, ai është krijuar si një Standard lehtësues, duke shmangur qëllimisht kornizat e ngurta normative me kufij të

vendosur e të përcaktuar për atë se çfarë duhet të realizojnë ZMN-të. Përkundrazi, Standardi është hartuar për të mbështetur përdoruesit që të zbatojnë, mësojnë, forcojnë e përmirësojnë vazhdimisht efektshmërinë, qëndrueshmërinë dhe përshtatshmërinë e ndërhyrjeve të tyre nëpërmjet ZMN-ve.


Ai gjithashtu shërben si një mekanizëm për zhvillimin e një qasjeje të qëndrueshme për hartimin dhe verifikimin e rezultateve konkrete të orientuara drejt zgjidhjeve. Përdorimi i këtij Standardi dhe vendosja e ZMN-ve tuaja në mënyrë sistematike, krijon mundësinë për të mbajtur parasysh hartimin dhe cilësinë e zbatimit për të gjurmuar rezultatet dhe për t'i lidhur ato me objektivat globale si dhe me përmbajtjen e kërtimeve. Për ndërhyrjet individuale në terren, zbatimi i Standardit ofron një vlerë reale të shtuar. Së pari, rezultati mund të rritë besueshmërinë për kryerjen e ndërhyrjes kur negociohet me investuesit, donatorët dhe aktorët e tjerë. Së dyti, përdorimi i Standardit ofron ndërhyrje individuale me rekomandime për përmirësime, duke i përdorur rezultatet si një mënyrë për të identifikuar mangësitë dhe zgjidhjet. Së treti, Standardi mund të përdoret si një mjet i angazhimit dhe komunikimit ndërmjet sektorëve, duke krijuar mundësinë për bisedime të reja dhe duke siguruar kornizën dhe gjuhën e përbashkët për të biseduar për kompromiset.

Kush mund ta përdorë Standardin?

Në bazë të parashikimeve të bëra nga IUCN-ja, pushteti qendror, pushteti vendor, planifikuesit, bizneset, donatorët, institucionet financuese ku përfshihen bankat për zhvillim dhe organizatat jofitimprurëse, do të jenë përdoruesit kryesorë të Standardit. Standardi mund të përdoret nga aktorët të cilët punojnë në një sërë kontekstesh, që nga zonat e mbrojtura e deri tek peizazhet prodhuese në zonat urbane, në rajone të ndryshme dhe në ekosisteme të modifikuara apo të paprekura. Përdoruesit mund ta zbatojnë Standardin si për ndërhyrje në shkallë të gjerë ashtu edhe në shkallë të vogël.

Si duket Standardi?

Standardi përbëhet nga 8 Kriteret dhe 28 Tregues (Figura 2). Kriteri 1 përqendrohet në identifikimin e sfidave shoqërore ndaj të cilave reagojnë ZMN-të.



© IUCN

Figura 2 Tetë Kriteret të cilat përbëjnë Standardin Global të IUCN-së për ZMN-të janë të gjitha të ndërlidhura.

Ndërkohë që fusha e zbatimit të sfidave shoqërore aktualisht përfshin ndryshimet klimatike (përshtatjen dhe zbutjen), zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, degradimin e ekosistemit dhe humbjen e biodiversitetit, sigurimin e ushqimit, shëndetin e njeriut, zhvillimin shoqëror dhe ekonomik dhe sigurimin e ujit, fusha e zbatimit të ZMN-ve mund të ketë sfida të tjera të caktuara brenda kësaj fushe të zbatimit, meqenëse ZMN-të evoluojnë në lidhje me fushën e zbatimit të tyre. Pika e fillimit mund të jenë një ose disa

sfida shoqërore; megjithatë, prioriteti është që ZMN-të e mundshme të ofrojnë përfitime shumëfishe, domethënë një ndërhyrje të adresojë disa sfida njëherësh.

Kriteri 2 udhëzon hartimin e zgjidhjes duke reaguar ndaj problemit në bazë të shkallës. Shkalla në këtë kontekst i referohet kryesisht shkallës gjeografike të tokës dhe detit, si dhe aspekteve ekonomike, ekologjike dhe shoqërore të peizazhit tokësor/detar. Zona e synuar, ku adresohet sfida shoqërore, është shpesh pjesë e një sistemi më të madh, si ekologjik ashtu edhe ekonomik apo shoqëror. Ndërkohë që veprimtaritë e ndërhyrjes mund të përqendrohen në shkallën e zonës, qëndrueshmëria, zbatueshmëria dhe reagimi i zgjidhjes duhet të marrin parasysh sistemin më të gjerë në fjalë.

Kriteri 3, 4 dhe 5 përkojnë me tri shtyllat e zhvillimit të qëndrueshëm: të qëndrueshëm në aspektin mjedisor, të barabartë në aspektin shoqëror dhe të realizueshëm në aspektin ekonomik. Për secilin Kriter, në mënyrë që të ofrohet një ZMN e efektshme dhe të marrin hov veprimet e qëndrueshme, kërkohet njohja e burimeve dhe kontekstit aktual në formën e një gjendjeje fillestare.

Kriteri 6 adreson balancimin e kompromiseve dhe zgjedhjeve që duhen bërë për të përfutur ndikime afatshkurtra dhe afatgjata, dhe mënyrën se si të sigurohet një proces transparent, i paanshëm dhe gjithëpërfshirës për përcaktimin e kompromiseve të tilla. Në bazë të natyrës dinamike të sistemeve të cilat ndikojnë tek zgjidhjet (Kriteri 2), është e rëndësishme të menaxhohet zbatimi i ZMN-ve në mënyrë sistematike kundrejt gjendjes fillestare. ZMN-të përdorin shërbimet e ekosistemeve, të cilat janë sisteme komplekse, dinamike dhe të vetëorganizuara. Ekosistemet mund të reagojnë në mënyrën e dëshirueshme ndaj një ndërhyrjeje ZMN-je ose ndërhyrja mund të shkaktojë pasoja të paqëllimshme, të paparashikueshme dhe të padëshirueshme. Për rrjedhojë, Kriteri 7 i përgjigjet nevojës për menaxhimin e përshtatur, i cili mundëson të nxënë të vazhdueshëm për proceset e të gjithë sistemit dhe përshtatjen e ZMN-ve ndaj ndryshimeve sistematike.

Potenciali i vërtetë i ZMN-ve realizohet përmes zbatimit të tij afatgjatë në mënyrë të shkallëzuar. Përfshirja e konceptit dhe veprimeve në dokumente politike apo korniza rregullatore, si dhe lidhja me objektivat kombëtare apo angazhimet ndërkombëtare, mund ta realizojnë këtë, ashtu siç promovohet në Kriterin 8.

Si mund të përdoret Standardi?

Standardi është konceptuar si një mjet i thjeshtë, praktik dhe i qëndrueshëm, i cili bën të mundur përkthimin e konceptit të ZMN-ve në veprime të synuara për zbatim, duke përfunduar praktikën më të mirë, duke adresuar dhe korrigjuar mangësitë dhe duke bërë të mundur që ndërhyrjet të jenë të harmonizuara me parimet e ZMN-ve të pranuar në nivel ndërkombëtar ([WCC-2016-Res-069](#)). Standardi mund të zbatohet duke përdorur mjetet ekzistuese të menaxhimit të projektit dhe qasjet teknike. Për rrjedhojë, harmonizimi i treguesve me sitemet raportuese dhe operative të menaxhimit e zvogëlon punën shtesë që nevojitet për të zbatuar një ndërhyrje të besueshme ZMN-je (Figura 3). Për më tepër, Standardi Global i ZMN-ve (Pjesa I) i cili është lehtësisht i përdorshëm dhe shërben si mjet vetëvlerësimi, shoqërohet me një [udhëzues](#) të detajuar, i cili përfshin sfondin shkencor për ZMN-të dhe ofron udhëzime të zgjeruara për Kriteret dhe Treguesit. Pjesa III është bashkëplotësuese e Standardit duke ofruar manualin e përdorimit, që paraqet mjetet e sugjeruara të verifikimit dhe një përmbledhje të mjeteve dhe qasjeve të cilat mund të përdoren për të zbatuar Standardin.

Për fazën fillestare të prezantimit të Standardit për ZMN-të, është krijuar mjeti i vetëvlerësimit për t'u dhënë mundësinë përdoruesve të Standardit të përllogarisin përqindjen e përfundimit të ndërhyrjes së tyre kundrejt të katër Kriterëve dhe të identifikojnë nëse ndërhyrja është në përputhje me Standardin Global të IUCN-së për ZMN-të. Mjeti i lejon përdoruesit të përcaktojnë për secilin Tregues, se sa mirë është realizuar ndërhyrja (e fuqishme, e përshtatshme, e dobët apo e pamjaftueshme), si dhe arsyetimet, mjetet e verifikimit dhe komentet. Mjeti më tej ofron një tabelë me zërat për secilin Tregues dhe një klasifikim të përgjithshëm se sa mirë ndërhyrja është në përputhje me Standardin duke përdorur treguesit me dritat e semaforit, ku ndërhyrja e cila shënon një rezultat “të pamjaftueshëm” për çdo Kriter, rrjedhimisht nuk është në përputhje me Standardin Global të IUCN-së për ZMN-të.

Sigurimi i një Standardi Global të qëndrueshëm për ZMN-të

Meqenëse përdoruesi është propozuar si pala e parë e verifikimit, ai e zbaton Standardin për të vlerësuar projektin/ndërhyrjen kundrejt Kriterëve dhe Treguesve të përcaktuar.




Figura 3 Qeverisja e Standardit nëpërmjet Komitetit të Standardit Ndërkombëtar dhe përmirësimi i Standardit. © IUCN

Qasja e vetëverifikimit në bazë të Standardit harmonizohet me objektivin e IUCN-së për të siguruar një Standard lehtësues, i cili mbështet përdoruesit e një spektri të gjerë të shoqërisë që të kalojnë në mënyrë të suksesshme drejt përdorimit të ZMN-ve të hartuara mirë, të zbatueshme dhe të qëndrueshme. Megjithatë, roli lehtësues nuk shmang kërkesën për besueshmëri dhe qëndrueshmëri gjatë zbatimit të Standardit. Një strukturë autoritare dhe e njohur e qeverisjes, si dhe një proces i qëndrueshëm i zbatimit me anë të përdorimit të qarkut të reagimit (feedback loop) të të nxënësve për të përmirësuar Standardin, janë për rrjedhojë hapat e ardhshëm të domosdoshëm për

prezantimin e Standardit. Struktura e përgjithshme e qeverisjes përbëhet nga katër komponentë kryesorë:

- *Komiteti Ndërkombëtar i Standardit si autoriteti gjithëpërfshirës, i cili përbëhet nga kryesia dhe përfaqësuesit e tri komponentëve të tjerë;*
- *Komiteti Shkencor, i cili është kryesisht përgjegjës për përmbajtjen e njohurive shkencore;*
- *Grupi i Përdoruesve, i cili mund të nxitë të nxënës dhe reagimin për zhvillimin e Standardit përmes mësimave të nxjerra nga zbatimet;*
- *Qendrat e përdorimit funksional (rajonale apo kombëtare), të cilat mbështesin përshtatjen e Standardit sipas kontekstit dhe zhvillimit vijues të zgjidhjeve për shoqërinë, ekonominë dhe mjedisin, të cilat janë të qëndrueshme dhe fitimprurëse në periudhën afatgjatë.*

Kjo strukturë do të sigurojë administrimin global të Standardit për të nxitur zbatimin e qëndrueshëm e të përshtatshëm të tij nga ana shkencore për përmbushjen e ambicies së ZMN-ve. Përmes një mekanizmi të tillë të administrimit dhe zbatimit të Standardit në kontekstin e caktuar (të tillë si ai kombëtar) mund të arrihet cilësia dhe siguria dhe në të njëjtën kohë ruhet edhe qëndrueshmëria. Për më tepër, një grup përdoruesish të gjerë mund të angazhohen për periudhën afatgjatë, meqenëse grupi do të ndihmojë për proceset e qarkut të reagimit (feedback loop) për të nxënës dhe përmirësimin e Standardit.

Kriteri 1: ZMN-të i adresojnë sfidat shoqërore në mënyrë të efektshme

Udhëzim:	Treguesit
<p>Qëllimi i këtij Kriteri është të sigurojë hartimin e ZMN-ve për të reaguar ndaj sfidës(ve) shoqërore, e cila është identifikuar si prioritare nga ata të cilët ndikohen apo do të ndikohen drejtpërdrejt nga sfida(t). Të gjithë aktorët, veçanërisht mbajtësit e të drejtave dhe përfituesit e ZMN-ve, duhet të përfshihen në procesin e vendimmarrjes së përdorur për identifikimin e sfidës(ve) prioritare (Kriteri 5).</p>	<p>1.1 Sfidat shoqërore më të rëndësishme për mbajtësit e të drejtave dhe përfituesit kanë prioritet Udhëzim: Ndërhyrja e ZMN-ve duhet të adresojë sfida të përcaktuara qartë, të cilat kanë ndikim të dukshëm dhe të demonstrueshëm në shoqëri. Identifikimi i sfidave shoqërore më të rëndësishme bëhet më së miri nga një proces konsultimi transparent dhe gjithëpërfshirës (Kriteri 5), duke qenë se mendimet ndërmjet aktorëve të jashtëm dhe komuniteteve lokale mund të jenë të ndryshme dhe anasjelltas.</p>
	<p>1.2 Sfida(t) shoqërore e adresuar kuptohet dhe dokumentohet qartë Udhëzim: Kuptimi dhe logjika e qartë për sfidat që do të adresohen, dhe sigurimi i dokumentimit të tyre, është i rëndësishëm për marrjen e përgjegjësisë të ardhshme dhe optimizimin e këtyre strategjive për të kontribuar në rezultatet për mirëqenien e njeriut (1.3). ZMN-të shpesh ofrojnë përfitime të shumëfishta shoqërore, të tilla si krijimi i vendeve të punës apo rritja e qarkullimit të shërbimeve në ekosistem, kështu që edhe sfidat shoqërore të cilat adresohen nga këto përfitime shtesë duhet të dokumentohen.</p>
	<p>1.3 Rezultatet për mirëqenien e njeriut që vijnë nga ZMN-të identifikohen, krahasohen dhe vlerësohen në mënyrë periodike Udhëzim: ZMN-të duhet të sjellin përfitime konkrete dhe të rëndësishme për mirëqenien e njeriut. Objektivat specifike, të matshme, të arritshme, realiste dhe të përpikta (SMART) [SMARP] duhet të përdoren siç duhet pasi janë të rëndësishme për llogaridhënien dhe informimin e menaxhimit të përshtatur (Kriteri 7).</p>

Sfidat shoqërore:



Figura 4 Sfidat kryesore shoqërore të adresuara nga ZMN-të. Gjashtë sfidat e para, nga e majta në të djathtë, u formuluan në bazë të përkufizimit të IUCN-së (IUCN, 2016). Sfidat e shtatë shoqërore, ndryshimi i degradimit të ekosistemit dhe humbjes së biodiversitetit, ishte rezultat i konsultimit të dytë publik për Standardin © IUCN

Figura 5 Fidanët që rriten në një fushë ku zbatohet Rigjenerimi i Ndihtuar Natyror, një metodë e thjeshtë e restaurimit të tokës me kosto të ulët. Duke ruajtur dhe inkurajuar rigjenerimin natyral të fidanëve, rritet prodhimtaria e tokës dhe si pasojë fidanët mund të ofrojnë hije dhe mbrojtje ndaj prodhimeve të tjera, duke kontribuar në këtë mënyrë në aftësinë ripërtëritëse përballë dukurive ekstreme.

© IUCN/EI Hadji Ballé

Rast studimor: Identifikimi i një sfide shoqërore¹

Senegali përballlet me rreziqe konkrete për shkak të ndryshimeve klimatike dhe fatkeqësive natyrore. Ndikimet e ndryshimeve klimatike karakterizohen kryesisht nga rreshje shiu të paparashikueshme, duke krijuar kripëzimin dhe degradimin e tokës, duke rritur rrezikun ndaj prodhimeve bujqësore dhe zhvillimit ekonomik të shkaktuar nga thatësi dhe shkretëtirëzim. Duke përdorur metodën e [Promovimit të Novacioneve Vendore](#), anëtarët e komunitetit përcaktuan sfidat e tyre shoqërore të tilla si: rreziqet nga fatkeqësitë, sigurimi i ushqimit dhe degradimi i ekosistemit. Ndërkohë që, fillimisht, hartimi i projektit përqëndrohej më shumë tek përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike dhe zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë, duke ndjekur procesin e planifikimit të komunitetit, menaxherët e projektit hartuan rishtazi veprimtari për t'i përfshirë të gjithë sfidat e

identifikuara. Praktikat e qëndrueshme bujqësore dhe forcimi i aftësive ripërtëritëse të banorëve dhe natyrës ndaj përmytjeve dhe ndikimeve të kripëzimit të tokës, ishin zgjidhjet e ZMN-ve që jepnin rezultat, të cilat u hartuan së bashku me komunitetet dhe u zbatuan në bashkëpunim me të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e konsultimit. Përfshirja e nevojave vendore si prioritet të projektit ishte relativisht e thjeshtë dhe ofronte përfitime të përbashkëta të tilla si: rehabilitimi i tokës, përfitime të biodiversitetit dhe rendiment më i lartë i prodhimeve ushqimore.

¹ Mont, F., Murti, R., Miththapala, S., and Buyck, C. (eds). (2017). Ecosystems protecting infrastructure and communities: lessons learned and guidelines for implementation (Ekosistemet në mbrojtje të infrastrukturës dhe komuniteteve: mësimet e nxjerra dhe udhëzimet për zbatimin). Gland, Switzerland: IUCN. <https://doi.org/10.2305/IUCN.CH.2017.14.en>

Kriteri 2: Hartimi i ZMN-ve informohet në bazë të shkallës

Udhëzim:	Treguesit
<p>Qëllimi i këtij Kriteri është të nxitë hartimin e ZMN-ve, duke njohur kompleksitetin dhe pasigurinë e peizazheve tokësore/detare dinamike. Vlerësimi në bazë të shkallës gjen zbatim jo vetëm tek pikëpamja biofizike apo gjeografike, por edhe tek ndikimi që ai ka në sistemet ekonomike, kornizat e politikave dhe pikëpamjet kulturore.</p> <p>Hartimi i ZMN-ve informohet nga niveli i njohurive të aktorëve për ndërveprimet ndërmjet aspekteve të ndryshme të peizazheve tokësore/detare, duke përdorur një kornizë me tri nivele shkallësh, e cila merr parasysh pjesët brenda peizazhit tokësor/detar; vetë peizazhin tokësor/detar dhe mjedisin e gjerë përreth peizazhit tokësor/detar. Një shembull do të ishin familjet brenda fshatrave dhe këto të fundit brenda një zone të nivelit vendor. Të kuptuarit e ndërveprimeve të cilat ndikojnë në veçori të tilla si vlerat kulturore, ligjet, toka, pyjet dhe uji, janë të rëndësishme në këtë drejtim, pasi ato i përkasin vlerësimit të rrezikut nga ndryshimi i padëshirueshëm, apo mundësisë së krijimit të ndryshimit të dëshirueshëm.</p> <p>Hartimi i ZMN-ve kërkon të ruajë kapacitetin prodhues të ekosistemeve si dhe krijimin e përfitimeve të domosdoshme për mirëqenien e njeriut.</p>	<p>2.1 Hartimi i ZMN-ve një ndërveprimet midis ekonomisë, shoqërisë dhe ekosistemeve dhe reagon ndaj tyre</p> <p>Udhëzim: Suksesi i ZMN-ve do të përcaktohet jo vetëm nga cilësia e ndërhyrjes teknike por edhe nga mënyra se si kuptohen dhe gjejnë zgjidhje ndërveprimet ndërmjet njerëzve, ekonomisë dhe ekosistemit. Në mënyrë që zgjidhjet të jenë të efektshme dhe të qëndrueshme, hartimi i ZMN-ve kërkon realizimin e një kornize për “sistemet” që i njëh dhe i adreson këto lloj ndërveprimesh dhe i ndërton ato gjatë procesit të vendimmarrjes.</p> <p>2.2 Hartimi i ZMN-ve integrohet me ndërhyrje të tjera bashkëplotësuese dhe kërkon sinergji ndërmjet sektorëve</p> <p>Udhëzim: ZMN-të do të kërkojnë integrimin e tyre në bashkëpunimin dhe bashkëplotësimin me lloje të tjera ndërhyrjesh, të tilla si projektet inxhinierike, teknologjia e informacionit, instrumentet financiare etj. Veprime të tilla bashkëplotësuese do të kërkojnë vazhdimisht identifikimin e sinergjive ndërmjet sektorëve të ndryshëm në bazë të specifikave dhe kontekstit të çdo shtate.</p> <p>2.3 Hartimi i ZMN-ve përfshin identifikimin e rrezikut dhe menaxhimin e rrezikut përtej zonës së ndërhyrjes</p> <p>Udhëzim: ZMN-të kanë kapacitetin për të ndikuar si pozitivisht ashtu edhe negativisht, apo të ndikohen nga aktorët, interesat dhe ekosistemet jashtë zonës së ndërhyrjes së menjëhershme. Në mënyrë që zgjidhja të jetë e efektshme dhe e qëndrueshme, lloje të tilla ndërhyrjesh si brenda ashtu edhe përreth zonës së ndërhyrjes, duhet të kuptohen dhe të merren parasysh në proceset e vendimmarrjes. Alternativat e duhura të menaxhimit të rrezikut duhet të përfshihen në hartimin e ndërhyrjes.</p>

Hartimi duke pasur parasysh metodën e shkallëzimit




Figura 6 Ilustrimi i marrjes parasysh të faktorëve përmes zonës së ndërhyrjes së menjëhershme, në mënyrë që të merren parasysh mundësitë, rreziqet dhe faktorët përkatës në bazë të shkallës gjatë hartimit të ZMN-ve. Për ZMN-të D, duhet të merren parasysh ZMN-të B-C në rrjedhën e sipërme, duke përfshirë lloje të tjera ndërhyrjesh të tilla si bujqësia apo infrastruktura rrugore. Gjatë përcaktimit të shkallës, mund të hartohen dhe kombinohen ZMN-të e ndryshme, si qasje e plotë për të adresuar sfidën(at) shoqërore. © IUCN



Figura 7 Kolegët e Autoritetit për Menaxhimin e Burimeve Ujore (AMBU) në Kenia duke instaluar tabelë matëse në lumin Tana © CIAT/Georgina Smith

Rast studimor: Hartimi duke pasur parasysh metodën e shkallëzimit – Kombinimi i ZMN-ve me infrastrukturën për ujërat për zgjidhjet me anë të metodës së shkallëzimit

Nëpërmjet kërkimit të zbatuar nën kujdesin e Projektit WISE-UP to Climate (NDRIÇOHU për Klimën), rezultatet treguan se infrastruktura natyrore është një pasuri kombëtare jetësore e cila mbështet jetesën, ruan zhvillimin ekonomik dhe ndihmon në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në basenin e lumit Tana (95 000 km²), Kenia. Për të shqyrtuar ndikimet e ndërhyrjeve nëpërmjet ndryshimit të funksionimit të infrastrukturës ekzistuese të ndërtuar, përmeshtimit të infrastrukturës së re (p.sh. Tunelit Verior të Kolektorit të Ujërave, Digës së Ujëvarave të Mëdha, skemat e reja të mëdha të ujitjes pranë deltës së lumit Tana) apo përmes investimit më të madh në infrastrukturën natyrore, u krijua një model simulimi për sistemin e basenit të lumit Tana. Për realizimin e këtyre arritjeve, u njohën dhe u vlerësuan përfitimet nga infrastruktura natyrore, duke përfshirë: aplikimin e peshkimit sezonal në zonën me prirje për t'u përmbytur, shmangien e përmbytjeve në zonat bujqësore me prirje për t'u përmbytur, peshkimin në rezervuarë, peshkimin në grykëderdhjen e lumit, kullotjen e bagëtive në zonat me prirje për t'u përmbytur, dhe transportimin e sedimenteve nga delta në bregdet. Ato arrijnë mesatarisht vlerën prej më shumë se 170 milionë dollarë amerikanë

në vit, duke kontribuar kryesisht ndaj fermerëve të vegjël dhe blegtorëve me të ardhura të pakëta në pjesën e poshtme të basenit të lumit Tana. Nëse këto përfitime do të ndërpriteshin apo do të zvogëloheshin, do të shfaqeshin sërish tensionet e mëtejshme për tokën dhe burimet ujore në pjesën e poshtme të basenit. Infrastruktura natyrore e basenit të lumit Tana ofron gjithashtu sigurimin e ujit dhe shërbimet e lidhura me biodiversitetin që vijnë nga infrastruktura aktuale me vlerë mesatare 139 milionë dollarë amerikanë në vit. Kaskada e digave në basenin e lumit Tana ofron përfitime të rëndësishme ekonomike: në lidhje me shitjen e energjisë elektrike prej të paktën 128 milionë dollarë amerikanë në vit dhe me ujitjen, 9 milionë dollarë amerikanë në vit. Baseni i lumit mbulon 65% të nevojave kombëtare të energjisë elektrike përmes hidrocentralit, dhe pothuajse të gjithë furnizimit të brendshëm me ujë të Nairobi për 4 milionë banorë. Rezultatet e projektit WISE-UP tregojnë se rritja e investimeve në infrastrukturën natyrore në pjesën e sipërme të ujëmbledhësit, të tilla si ato të ndërmarra nga Fondi i Ujërave të Nairobi, ka të ngjarë që ta përmirësojnë më tej performancën e digave dhe të ruajnë përfitimet e marra, madje edhe përballë ndryshimeve të ardhshme klimatike.²

Kriteri 3: ZMN-të rezultojnë me përfitim për integritetin e biodiversitetit dhe të ekosistemit

Udhëzim:	Treguesit
<p>ZMN-të përftohen në formën e mallrave dhe shërbimeve nga ekosistemet, dhe për rrjedhojë varen fuqishëm nga shëndeti i një ekosistemi. Humbja e biodiversitetit dhe ndryshimi i ekosistemit mund të kenë ndikim të madh në funksionimin dhe integritetin e sistemit. Për rrjedhojë, hartimi dhe zbatimi i ZMN-ve duhet të shmangë dëmtimin e integritetit të sistemit dhe të kërkojë në mënyrë aktive rritjen e funksionimit dhe lidhshmërisë së ekosistemit. Në këtë mënyrë, mund të sigurohet gjithashtu aftësia ripërtëritëse dhe qëndrueshmëria e ZMN-ve.</p>	<p>3.1 Veprimet e ZMN-ve reagojnë drejtpërdrejt ndaj vlerësimit të bazuar në fakte për gjendjen aktuale të ekosistemit dhe shkaqet mbizotëruese të degradimit dhe humbjes</p> <p>Udhëzim: Për zhvillimin e një zgjidhjeje të mbështetur tek natyra, duhet të kuptohet qartë gjendja aktuale e ekosistemeve të caktuara. Vlerësimi i gjendjes fillestare duhet të përqendrohet tek karakterizimi i gjendjes ekologjike, shkaktarët e humbjes së ekosistemit dhe mundësitë e përmirësimit, duke përdorur në këtë mënyrë si njohuritë vendore ashtu edhe bazën shkencore aty ku është e mundur.</p>
	<p>3.2 Rezultatet e qarta dhe të matshme të ruajtjes së biodiversitetit identifikohen, krahasohen dhe vlerësohen në mënyrë periodike</p> <p>Udhëzim: Në mënyrë që të ofrohet informacioni për hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e ZMN-ve, duhet të përcaktohen objektivat për rritjen e vlerave kryesore të biodiversitetit. Lloji i objektivit mund të jetë i ndryshëm në varësi të secilës ZMN; për shembull, si objektiv mund të jetë përqindja e ekosistemit të restauruar apo rikthimi i llojeve kryesore.</p>
	<p>3.3 Monitorimi përfshin vlerësime periodike të pasojave të dëmshme por të paqëllimshme ndaj natyrës të cilat vijnë nga ZMN-të</p> <p>Udhëzim: Ekosistemet janë komplekse me komponentë dhe procese të ndërvarura. Gjithmonë do të ketë pasiguri në mënyrën se si ato do të reagojnë ndaj ndërhyrjeve të caktuara apo ndryshimeve të tjera të jashtme. Për rrjedhojë, ZMN-të duhet të hartohen dhe monitorohen në mënyrë të tillë që t'i zvogëlojnë rreziqet e paparashikuara të cilat mund të çenojnë themelet ekologjike të vetë zgjidhjes.</p>
	<p>3.4 Mundësitë për të rritur integritetin dhe lidhshmërinë e ekosistemit identifikohen dhe përfshihen në strategjinë e ZMN-së</p> <p>Udhëzim: Përdorimi i ZMN-ve mund të ofrojë mundësinë për të nxitur ruajtjen e biodiversitetit dhe përpjekjet për menaxhimin e ekosistemit në mënyra të cilat për llojet e tjera të ndërhyrjeve të veçuara (të tilla si ndërhyrjet inxhinierike) mund të jenë të përzgjedhshme. Nëse zgjidhjet do të zbatohen pranë ekosistemeve natyrore të cilat menaxhohen kryesisht për rezultatet e ruajtjes, ZMN-të duhet të hartohen për të realizuar lidhshmërinë e ekosistemit. Për më tepër, ato mund të hartohen për riprezantimin e komponentëve të humbur të një ekosistemi ekzistues, për shembull, duke zgjedhur qëllimisht llojet e mëparshme ekzistuese të vegetacionit gjatë restaurimit.</p>

Përfitimet e biodiversitetit




Figura 8 Marrëdhënia ndërmjet kompleksitetit ekologjik dhe optimizimit të shërbimeve të ekosistemit, dhe niveli i ekosistemeve inxhinierike. (Përshtatur nga Balian, Eggermont & Le Roux (2014))



Figura 9 Pamje ajrore e projektit Medmerry. Aktorët vendorë, së bashku me përfaqësuesit e Agjencisë së Mjedisit, shkuan për të parë çarjen e gjerë prej 110 m të një bregu ekzistues me gurë, duke mundësuar futjen në brendësi të ujit të detit duke krijuar një habitat të ri bregdetar prej 180 ha. © Agjencia e Mjedisit. Përmban informacion të sektorit publik të licensuar në bazë të Licensës së Hapur të Qeverisë, v 3.0.

Rast studimor: Demonstrimi i përfitimeve të biodiversitetit: Ri-harmonizimi i bregdetit në shkallë të gjerë duke përdorur ZMN-të mund të (ri)krijojë habitate të biodiversitetit

Pas 50 vitesh përvojë nga ndërhyrjet tradicionale të tilla si pritrat dhe argjinaturat, Mbretëria e Bashkuar ka ndryshuar qasjen e saj për trajtimin e përmbytjeve bregdetare dhe stuhive. Projekti Medmerry është ri-harmonizimi i menaxhuar në shkallë të gjerë i infrastrukturës për mbrojtjen bregdetare, i cili kombinon përdorimin e vegjetacionit natyror bregdetar si mbrojtje fizike, me riharmonizimin e infrastrukturës inxhinierike për të tërhequr dhe drejtuar vijën bregdetare në drejtim të tokës. Kjo bën që ujërat të futen më tej në drejtim të tokës, duke zvogëluar rreziqet e përmbytjes së qytezave fqinje, ndërkohë që toka e sakrifikuar po kthehet gjithnjë e më shumë në një habitat të llojeve

të ndryshme.³ Iniciativa përfshin studime sistematike dhe të përsëritura shkencore për ofrimin e përvojave të fituara nga dështimi i infrastrukturës inxhinierike dhe kostove të shoqëruara me humbjet nga ndikimi i rreziqeve natyrore, si dhe njohuritë dhe përvojën e aktorëve vendorë, duke përfshirë 360 banorë apo pronarë pronash, shumica e të cilave fermerë bregdetarë. Iniciativa e riharmonizimit menaxhohet në bashkëpunim me qeverinë dhe aktorët vendorë përmes një angazhimi të madh për të informuar zbatimin e vazhdueshëm të experimentimeve dhe përvojave të tjera të ngjashme.⁴

3 Thomas, A. Medmerry. Coastal Realignment: Success for People and Wildlife. (Riharmonizimi Bregdetar: Suksemi për Njerëzit dhe Botën e Egër) (RSPB, unpublished).

4 Pethick, J. (2002). Estuarine and tidal wetland restoration in the United Kingdom: policy versus practice. (Restaurimi i ligatinave nga grykëderdhjet e lumit dhe bregdeti në Mbretërinë e Bashkuar: politika kundrejt praktikës). Restoration Ecology 10: 431 -437. <https://doi.org/10.1046/j.1526-100X.2002.01033.x>

Kriteri 4: ZMN janë ekonomikisht të realizueshme

Udhëzim:	Treguesit
<p>Kthimi i investimit, efikasiteti dhe efektshmëria e ndërhyrjes, dhe barazia në shpërndarjen e përfitimeve dhe kostove janë përcaktuesit kryesorë të suksesit të ZMN-ve. Ky Kriter kërkon që realizueshmërisë ekonomike t' i kushtohet vëmendja e duhur, si në fazën e hartimit ashtu edhe gjatë monitorimit dhe zbatimit.</p> <p>Në mënyrë që ZMN-të të jenë të qëndrueshme, vëmendje e madhe duhet t' i kushtohet aspekteve ekonomike, meqenëse ka të ngjarë që fitimet afatgjata të balancohen kundrejt kostove afatshkurtra, me veprime afatshkurtra të krijuara brenda kontekstit të objektivave dhe planeve afatgjata (duke u përçarur tek brezat).</p> <p>Nëse fizibiliteti ekonomik nuk adresohet siç duhet, ZMN-të përballen me rrezikun e të qenurit projekte afatshkurtra, ku, pas mbylljes, zgjidhjet dhe përfitimet e siguruara mbarojnë së ekzistuari, me shumë mundësi duke i lënë peizazhet dhe komunitetet në gjendje më të mjerë se më parë.</p> <p>Mjetet novatore dhe të bazuara në të dhëna për vlerësimin e natyrës, së bashku me idetë për kontributet e ZMN-ve ndaj tregjeve dhe vendeve të punës, nxisin financimin krijues (të kombinuar), duke rritur për rrjedhojë, mundësinë për suksesin e tyre afatgjatë.</p>	<p>4.1 Përfitimet dhe kostot direkte dhe indirekte të shoqëruara me ZMN-të, kush paguan dhe kush përfiton, identifikohen dhe dokumentohen</p> <p>Udhëzim: Identifikimi dhe dokumentimi i përfitimeve kryesore, duke përfshirë në mënyrë direkte dhe indirekte elementët e tyre financiarë dhe jo financiarë, janë komponentët kryesorë për vlerësimin e fizibilitetit ekonomik të ndërhyrjes, gjatë periudhës kohore. Ky informacion duhet të bëjë dallimin midis atij që merr përfitimet dhe atij që përballon kostot.</p> <p>4.2 Studimi për efektshmërinë e kostove sigurohet për të mbështetur zgjedhjen e ZMN-ve duke përfshirë ndikimin e mundshëm të ndonjë rregulloreje apo subvencionimi përkatës</p> <p>Udhëzim: Investimi i madh me kosto paraprake pa marrë parasysh qëndrueshmërinë ekonomike dhe financiare në periudhën afatgjatë, mund të sjellë pasoja negative për efektshmërinë e ndërhyrjes. Studimi për efektshmërinë e kostove jo vetëm krijon mundësinë e shqyrtimit të kostove të paguara paraprakisht dhe kostove fikse kundrejt përfitimeve të përshpejtuara afatgjata të ndërhyrjes(ve) së propozuar përgjatë periudhës kohore, por gjithashtu lejon që supozimet kryesore (apo të fshehura) të bëhen të qarta, të testohen apo të verifikohen.</p> <p>4.3 Efektshmëria e hartimit të ZMN-ve justifikohet kundrejt zgjidhjeve alternative të disponueshme, duke marrë parasysh çdo pasojë shoqëruese</p> <p>Udhëzim: Veçoria kryesore e ZMN-ve është se ajo mund të adresojë të paktën një sfidë shoqërore në mënyrë të qëndrueshme dhe të efektshme ekonomikisht. Kjo do të thotë se efektshmëria e kostove dhe përballueshmëria e zgjidhjes duhet të testohen kundrejt alternativave të qëndrueshme. Zgjidhjet alternative mund të përfshijnë një zgjidhje ndryshe të mbështetur tek natyra (për shembull zgjedhja e menaxhimit të pellgut ujëmbledhës sesa menaxhimi i zonës me prirje për t' u përmbytur), një kombinim ndryshe të zgjidhjeve tradicionale me ato të mbështetura tek natyra, ose zëvendësimin e zgjidhjes së mbështetur tek natyra me një qasje më tradicionale të tillë si infrastruktura inxhinierike.</p> <p>4.4 Hartimi i ZMN-ve shqyrton paketën e mundësive për burime të tilla si ato që ofrohen nga tregu, sektori publik, angazhimet vullnetare dhe veprimet për të mbështetur përputhjen me rregulloret</p> <p>Udhëzim: Fakti që ZMN-të ofrojnë njëkohësisht përfitime të shumta ndaj aktorëve të ndryshëm, mund të vendosë kufizime në disa burime financimi, duke dëmtuar realizueshmërinë afatgjatë të ndërhyrjeve. Për shembull, investuesit privatë mund të mos duan të përballojnë kostot e kryerjes së shërbimeve publike apo autoritetet publike mund të mos duan të mbulojnë kostot për përfitimet të cilat mbulohen privatisht. Kjo mund të kërkojë një paketë burimesh, e cilat integron një sërë mekanizmesh financiare. Burimet e investimeve mund të përfshijnë grantet e sektorit publik, stimujt dhe kreditë me interesa të ulëta, kreditë dhe aksionet e sektorit privat, parteneritetet publike dhe private (PPP) si dhe kontributet filantropike dhe vullnetare apo kombinimet e përmendura më lart, duke pasqyruar shpërndarjen e barabartë të rreziqeve dhe të fitimeve.</p>

Realizueshmëria ekonomike




Figura 10 Analiza kosto-fitim e mbrojtjes nga dëmet natyrore dhe ndryshimet klimatike përmes investimit në ekosisteme bregdetare dhe masa të tjera, Barbados (Përshtatur nga Mueller dhe Bresch, 2014, burimi: Grupi i Punës ECA, CCRIF)



Figura 11 Parku Kombëtar Folkestone, Barbados © Gary J. Wood/Flickr

Rast studimor: Menaxhimi i ekosistemit bregdetar si ZMN për krizat klimatike⁵

Humbja e mundshme ekonomike në Barbados nga rreziqet e klimës mund të arrijë deri në 279 milionë dollarë amerikanë në vit deri më 2030, duke marrë parasysh një vlerë të llogaritur prej 84 milionë dollarë amerikanë të humbjes së mundshme mesatare vjetore shtesë, e cila shkaktohet nga rritja e grumbullimit të asetëve si rezultat i zhvillimit ekonomik gjatë asaj periudhe. Për më tepër, skenari i ndryshimeve të mëdha klimatike, i cili pasqyron rritje të nivelit të detit, uraganë më të fuqishëm dhe fundosje të tokës, përlogaritet me një shifër shtesë prej 56 milionë dollarë amerikanë duke shkaktuar një humbje të pritshme totale prej 279 milionë dollarë amerikanë deri më 2030. Në përgjithësi, humbja e pritshme si përpjesëtim i PBB mund të ngrihet në vlerat 2% dhe 9% në skenarin ndryshimit të madh të klimës deri më 2030. Barbados, përmes kostove të efektshme mund të shmangë më shumë se një të tretën e humbjeve të pritshme, duke zbatuar iniciativat e zbutjeve të rrezikut, të tilla si mbushja e plazhit me rërë dhe ripërtëritja e gumës koralore dhe mangroveve-rizoforeve. Mbrojtja e Parkut Detar Folkstone në bregun perëndimor

të Barbados dhe sigurimi i ripërtëritjes së gumës koralore dhe mangroveve-rizoforeve mund të sjellë një ulje të humbjeve prej 20 milionë dollarë amerikanë në vit për një kosto vjetore prej vetëm 1 milionë dollarë amerikanë. Përfitime shtesë janë restaurimi natyror dhe rindërtimi i habitateve, së bashku me atraksionet e ekoturizmit. Për më tepër, pyjet me mangrove-rizofore mund të bllokojnë nën to sedimentime që për rrjedhojë zvogëlojnë erozionin dhe mund të përballojnë dallgët prej 5 deri në 7 metra apo më të larta. Megjithatë, ripërtëritja e mangroveve-rizofore në Parkun Detar Folkstone jo vetëm që kërkon burime financiare, por gjithashtu edhe ndryshimin kulturor – mangrovët-rizoforet shikohen aktualisht si problematike, sepse janë terrene ku shumohen mushkonjat, kanë kutërbim të pakëndshëm, dhe mbyllin daljen për në det. Përpjekjet e hershme për të kultivuar mangrove-rizofore mund të zhduken nga stuhitë deri sa mangrovët-rizofore të zënë vend. Së fundmi, efektshmëria e plotë e mangroveve-rizofore për zvogëlimin e rrezikut kërkon pyll të maturuar për to.

⁵ Mueller, L. And Bresch, D. (2014). "Economics of climate adaptation in Barbados – Facts for decision making" (Ekonomia e përshtatjes së klimës në Barbados- Faktet për Vendimmarrjen). In: R. Murti and C. Buyk (eds.), Safe Havens: Protected Areas for Disaster Risk Reduction and Climate Change Adaptation, pp, 15-21. Gland, Switzerland: IUCN. <https://portals.iucn.org/library/node/44887>

Kriteri 5: ZMN-të bazohen në proceset qeverisëse gjithëpërfshirëse, transparente dhe fuqizuese

Udhëzim:	Treguesit
<p>Ky kriter kërkon që ndërhyrjet e ZMN-ve të njohin, përfshijnë dhe reagojnë ndaj shqetësimeve të një sërë aktorëve, veçanërisht mbajtësve të të drejtave.</p> <p>Marrëveshjet për qeverisjen e mirë kanë dhënë prova që jo vetëm zvogëlojnë rreziqet ndaj qëndrueshmërisë së një ndërhyrjeje, por gjithashtu i japin asaj “licensën për të vepruar”. Në të kundërt, nëse qeverisja nuk është e duhur, pavarësisht se veprimet janë konceptuar më së miri, ajo mund të ndikojë në legjitimitetin e përfitimeve dhe ndarjen e kostove.</p> <p>ZMN-të të paktën duhet të jenë në përputhje me dispozitat mbizotëruese ligjore dhe rregullatore, duke përcaktuar qartë kufijtë se deri ku shtrihen përgjegjësitë ligjore. Megjithatë, siç ndodh shpesh me burimet natyrore, përputhshmëria me ligjet bazë do të duhet të plotësohet me mekanizmat mbështetëse të cilët angazhojnë dhe fuqizojnë në mënyrë aktive komunitetet dhe aktorët e tjerë të ndikuar.</p>	<p>5.1 Mekanizmi i reagimit dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve i përcaktuar dhe i miratuar plotësisht vihet në dispozicion të të gjithë aktorëve përpara se të fillojë ndërhyrja e një ZMN-je</p> <p>Udhëzim: Mekanizmat e zgjidhjes për reagimet dhe pakënaqësitë mund të përfshijnë sistemet formale, ligjore apo joformale, joligjore të ankimeve, të cilat funksionojnë në bazë të një numri të qartë të procedurave, roleve dhe rregullave për marrjen e ankesave dhe ofrimin e zgjidhjes. Mekanizmat efikase të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve karakterizohen nga pranimi dhe legjitimiteti i tyre ndërmjet aktorëve të ndikuar, transparencës, aksesimit dhe përdorimit të qasjeve të bazuara tek të drejtat. Ato duhet të funksionojnë në mënyrë të parashikueshme e të barabartë, dhe të bazohen në angazhim dhe dialog.</p>
	<p>5.2 Pjesëmarrja bazohet tek respekti dhe barazia e ndërsjelltë, pavarësisht gjinisë, moshës apo statusit shoqëror, dhe mbrohet të drejtën e Popujve Autoktonë për Pëlqimin e Lirë, Paraprak dhe të Informuar (PLPI)</p> <p>Udhëzim: Në mënyrë që organizimet e qeverisjes të funksionojnë siç pritet, të gjithë aktorët e ndikuar duhet të njoftohen në kohën e duhur dhe kontributet e tyre të adresohen me përpikmëri. Në këtë mënyrë, përpjekje të vetëdijshme duhet të bëhen për të sjellë në proces grupet e përjashtuara tradicionalisht, të cilët ruajnë dinjitetin e tyre dhe rrisin pjesëmarrjen duke marrë pjesë në mënyrë aktive. Ky është veçanërisht rasti kur një ZMN funksionon apo ndikon në tokat apo territoret e njerëzve autoktonë, ku e drejta e tyre për të vetëpërcaktuar ndërhyrjet dhe rezultatet duhet të ndjekë protokollin e krijuar për PLPI.</p>
	<p>5.3. Aktorët të cilët ndikohen direkt apo indirekt nga ZMN-ja identifikohen dhe përfshihen në të gjitha proceset e ndërhyrjes së ZMN-së</p> <p>Udhëzim: Planifikimi dhe analizi i aktorëve identifikon ata të cilët mund të ndikohen direkt apo indirekt, pozitivisht apo negativisht nga ZMN-të. Kjo bën të mundur që aktorët e ndikuar të kenë mundësinë të angazhohen dhe të marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e ndërhyrjes, të mbrojnë dhe ruajnë të drejtat dhe interesat e tyre, dhe ku të jetë e nevojshme, të parandalojnë marginalizimin e mëtejshëm.</p>
	<p>5.4 Proceset e vendimmarrjes dokumentojnë të drejtat dhe interesat e aktorëve të ndikuar dhe reagojnë ndaj tyre</p> <p>Udhëzim: Dokumentimi transparent dhe i aksesueshëm duhet të regjistrojë hapat kryesore të procedurave të vendimmarrjes për ZMN-të. Kjo do të ndihmojë rritjen e përgjegjësisë dhe do të sigurojë një bazë të fortë për rekurs në rastet e polemikave apo mosmarrëveshjeve. Vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet mbajtjes së shënimeve për pjesëmarrjen e aktorëve në vendimmarrje dhe rolet që u ishin caktuar. Kjo procedurë shërben veçanërisht kur mbizotëron pabarazia e theksuar në mënyrë që të përshtatet proceset për nxitjen e pjesëmarrjes së arsyeshme dhe efikase.</p>
	<p>5.5 Aty ku shkalla e ZMN-së shtrihet përtej kufijve territorialë, krijohen mekanizmat për të mundësuar vendimmarrjen e përbashkët të aktorëve në territoret e ndikuara</p> <p>Udhëzim: Ekosistemet nuk ndjekin kufijtë politikë dhe administrativë. Aty ku është e përshtatshme, marrëveshjet ndërkufitare të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve përkatëse mbështesin planifikimin dhe zbatimin e ZMN-ve ndërmjet kufijve, për të ndihmuar sigurimin e koherencës dhe qëndrueshmërisë së qasjes dhe rezultateve të dëshiruara.</p>

Qeverisja gjithëpërfshirëse




Figura 12 Suksesi i menjëhershëm dhe afatgjatë i ZMN-ve varet nga proceset gjithëpërfshirëse, transparente të angazhimit, menaxhimit dhe drejtimit. © IUCN



Figura 13 Krijimi i përbashkët i eksperimentit për parkun linear në Antverp me anë të një veprimtarie “ëndërrimtare”. © Stadslab 20150, Antwerp, 17.09.2017

Rast studimor: Planifikimi dhe zbatimi bashkëpunues i ZMN-ve urbane në Sint Andries

Planifikuesit urbanë kur planifikojnë dhe zbatojnë duhet të jenë të hapur ndaj mekanizmave bashkëpunuese të qeverisjes. Kjo jo vetëm përmban procese që përfshijnë aktorë të ndryshëm në hartimin dhe ekzekutimin, por gjithashtu merr parasysh edhe krijimin e institucioneve të reja për vënien në funksion dhe realizimin e ZMN-ve në periudhën afatgjatë. Në Antverp, një veprimtari “ëndërrimtare” e zhvilluar më 2017 për një korridor të gjelbër që lidhte ZMN-të e ndryshme për sigurimin e ujit, përfshiu autoritete dhe banorë të një qarku në Sint Andries. Kjo u përdor për të krijuar dhe nisur së bashku një eksperiment për identifikimin e hapësirave për prezantimin e zgjidhjeve të ndryshme të mbështetura te natyra për ruajtjen e ujit, të tilla si kanale

kullues biologjikë, apo kanale kullues me vegjetacion me funde poroze. Në veprimtari u përfshinë njerëz nga formime, kualifikime dhe dije të ndryshme dhe gjatë procesit u mbledhën kontributet e tyre vizuale dhe verbale. Ky përshkrim narrativ dhe vizioni i përbashkët i ZMN-ve shkaktoi ndryshime në mënyrën se si banorët i perceptonin institucionet vendore dhe rritën dëshirën e përvetësimit të ZMN-ve nga aktorët. Përmes analizimit të rasteve të tilla si Sint Andries, qeverisja bashkëpunuese kundërjet qeverisjes së drejtuar nga investuesit, është identifikuar si një nga shtatë faktorët kryesorë për zbatimin e suksesshëm të ZMN-ve në qytete.

Kriteri 6: NZMN-të balancojnë kompromiset për përmbushjen e objektivit(ve) të tyre kryesor dhe sigurimin e vazhdueshëm të përfitimeve të shumëfishta

<p>Udhëzim:</p> <p>Kompromiset për menaxhimin e tokës dhe burimeve natyrore janë të pashmangshme. Ekosistemet ofrojnë një sërë përfitimesh të ndryshme dhe jo të gjithë vlerësojnë secilin prej tyre në të njëjtën mënyrë. Pavarësisht se kompromiset nuk mund të shmangen, ato mund të menaxhohen në mënyrë të efektshme dhe të barabartë.</p> <p>Ky Kriter kërkon që mbështetësit e ZMN-ve të njohin këto kompromise dhe të ndjekin një proces të drejtë, transparent dhe gjithëpërfshirës për t'i balancuar dhe menaxhuar ato si në kohë ashtu edhe në hapësirë gjeografike. Kjo përfshin një vlerësim të besueshëm, paraqitje dhe marrëveshje të plotë ndërmjet aktorëve më të ndikuar për mënyrën se si duhet të adresohen kompromiset.</p> <p>Negocimi i drejtë dhe transparent për kompromise dhe kompensim ndërmjet palëve të mundshme të ndikuara për çdo dëm apo kompromis për mundësitë dhe jetesën lokale, siguron bazën për rezultate të suksesshme afatgjata të ZMN-ve. Me rëndësi është fakti të kuptohet se kompromiset kanë kufizime shoqërore dhe ekologjike përtej të cilave disa vlera apo përfitime mund të humbasin në vazhdimësi. Kjo do të thotë se do të kërkohej mbrojtje e cila, ndër të tjera, të sigurojë se nuk do të tejkalohen integriteti i ekosistemeve dhe vetitë afatgjata stabilizuese të shërbimeve të ekosistemit.</p>	<p>Treguesit</p> <p>6.1 Kostot dhe përfitimet e mundshme të kompromiseve të caktuara për ndërhyrjen e ZMN-ve njihen qartë dhe informojnë për masat mbrojtëse dhe çdo veprim të duhur korrigjues</p> <p>Udhëzim: Të gjitha kompromiset shoqërohen nga një paketë kostosh dhe përfitimesh të cilat mund t'i nënshtrohen ndryshimit gjatë gjithë kohëzgjatjes së ZMN-ve. Funkzioni kryesor i masave mbrojtëse për ZMN-të është të sigurojë që kompromiset e domosdoshme të mos ndikojnë negativisht në elementët më të pafavorizuar të shoqërisë, dhe është rreptësisht e ndaluar që ata të përdoren për të nxjerrë përfitime nga ndërhyrja. Për rrjedhojë, është e rëndësishme që kostot dhe përfitimet për kryerjen e kompromiseve të kuptohen plotësisht, të ndahen gjerësisht ndërmjet aktorëve të ndikuar, dhe të rishikohen në mënyrë periodike (6.3).</p> <p>6.2 Të drejtat, përdorimi dhe aksesimi i tokës dhe burimeve, së bashku me përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm, njihen dhe respektohen</p> <p>Udhëzim: Të drejtat ligjore dhe zakonore për aksesimin, përdorimin dhe kontrollimin e menaxhimit të tokës dhe burimeve natyrore, veçanërisht të grupeve të cënuara dhe të marginalizuara, duhet të respektohen dhe të ruhen. Të drejtat, përdorimi dhe përgjegjësitë e grupeve të aktorëve në lidhje me ZMN-të duhet të analizohen dhe vlerësohen, duke përdorur mjetet e duhura dhe duke ndërtuar mbi rezultatet e analizimit apo hartëzimit të aktorëve (5.3). Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur kemi të bëjmë me komunitetet autoktone, ku duhet të përdoret Pëlqimi i Lirë, Paraprak dhe i Informuar (PLPI) (5.2).</p> <p>6.3 Masat e krijuara mbrojtëse rishikohen në mënyrë periodike për të siguruar se kufijtë e kompromiseve të ndërsjellta respektohen dhe nuk çrregullojnë të gjithë ndërhyrjen e ZMN-ve</p> <p>Udhëzim: Aty ku rreziku është i pashmangshëm, masat mbrojtëse duhet të zbatohen dhe të rishikohen në mënyrë periodike, për t'i paraprirë pasojave të dëmshme të ndërhyrjeve dhe për t'i shmangur ato, veçanërisht duke marrë parasysh se pabarazia e kompromiseve mund të ndryshojë gjatë periudhës kohore dhe të gjithë aktorët mund të mos ndikohen njësoj. Për rrjedhojë, hartimi dhe strategjia e ZMN-ve duhet të jenë të qarta për përcaktimin se kush do të marrë përfitimet dhe kush do të adresojë kostot, duke përfshirë kohën dhe mënyrën e rishikimit. Masat mbrojtëse, mund të zbatohen për biodiversitetin (p.sh. duke përcaktuar një zonë të caktuar për mbrojtje apo duke kufizuar kohën e peshkimit) dhe për njerëzit (p.sh. procedurale – mekanizmat e ankimeve, detyrimet për konsultime, e drejta për të apeluar, apo ligjore – kontratat, dispozitat ligjore dhe rregullatore).</p>
--	---

Balancimi i kompromiseve




Figura 14 Balancimi i kompromiseve mbështetet në kuptimin e përfitimeve, kostove dhe rreziqeve që vijnë nga ndërhyrja gjatë periudhës kohore. © IUCN

Figura 15 Ruajtja e Hilsës
Takimi i Grupit në Barisal
Bangladesh më 2015.
© WorldFish, Flickr



Rast studimor: Gjetja e mangësive nga të cilat nxirren mësim – siguri ushqimor dhe ruajtja e peshkut në Bangladesh

Në Bangladesh, aty ku 11% e jetesës së popullsisë varen nga peshkimi, peshku hilsa është një nga ushqimet kryesore të konsumit të gjerë në vend, duke kontribuar me 1% ndaj PBB më 2016. Popullatat e hilsës kanë rënë në mënyrë drastike më 1990, duke kërcënuar jetët e tri milionë peshkatarëve. Shkaqet kryesore të rënies së këtij lloji u identifikuan të ishin peshkimi pa kriter dhe degradimi i habitateve. Në mënyrë që të adresohen sfidat kryesore të sigurimit të ushqimit dhe zhvillimit ekonomik, Plani i Veprimit për Menaxhimin e Peshkimit të Hilsës u fut në zbatim më 2003, ku u përfshinë krijimi i rezervave natyrore për rritjen dhe shumimin, duke zbatuar moratoriumin e përkohshëm vjetor të peshkimit për të lejuar ripërtëritjen e popullatave, dhe duke ekzekutuar Aktin e Mbrojtjes dhe Ruajtjes së Peshkut. Në të njëjtën kohë, pas vlerësimit të kompromiseve dhe për të adresuar kostot të cilat lidhen me moratoriumin, u vendos një tarifë për skemat e shërbimeve të ekosistemit, duke u ofruar komuniteteve të peshkatarëve oriz, në këmbim të ndërprerjes së peshkimit në zonat e ndikuara. Me kalimin e kohës, meqenëse popullatat e peshkut u rritën, kjo rriti disponueshmërinë e ushqimit dhe të ardhurat nga

peshkimi, duke siguruar përfitime të përbashkëta shtesë të tilla si përmirësimi i shëndetit për shkak të krijimit të të ardhurave më të larta dhe mundësia për të blerë mjekime, si dhe rritja e qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike. Megjithatë, pati edhe pasoja të papritura dhe mangësi të njohurive të tilla si: peshkimi i cili nuk po e merrte veten aq shpejt sa pritej, mungesa e proteinave në dietën e njerëzve të ndikuar, dhe peshkatarët të cilët ishin të detyruar të merrnin kredi gjatë moratoriumit të peshkimit. Kompromiset ndryshuan shumë ndërmjet aktorëve të ndikuar. Përfitimet dhe kostot vareshin nga aspekte të tilla se në cilin zinxhir të ofertës gjendej njëri, nëse peshkimi po përparonte apo po falimentonte në zonat me peshkim intensiv, dhe se sa afër ndodhej dikush me rezervën natyrore. Kostot afatshkurtra, të tilla si rënia e çmimit të peshkut kur peshku pushtonte tregun, ndiheshin se tejkalonin përfitimet afatgjata. Rivlerësimi i kompromiseve krijoi njohuritë e nevojshme për të ndryshuar kompensimin dhe për të rritur mbështetjen dhe aksesin ndaj mikrofinancës. Si rezultat, peshkatarëve iu dhanë stimuj për të bashkëpunuar për mbrojtjen e hilsës në mënyrë vullnetare.⁶

6 Reid, H. And Ali, L (2019). Ecosystem-based approaches to adaptation: strengthening the evidence and informing policy (Qasjet e mbështetura në ekosistem për përshtatjen: forcimi i fakteve dhe politikave informuese). Research results from the incentive-based Hilsa Conservation Programme, Bangladesh, London, UK: IIED. <http://pubs.iied.org/17625IIED>

Kriteri 7: ZMN-të menaxhohen në mënyrë të përshtatur, duke u bazuar në fakte.

Udhëzim:	Treguesit
<p>Ky kriter kërkon që planet për zbatimin e ZMN-ve të përfshijnë dispozitat për të përdorur menaxhimin e përshtatur si një reagim ndaj pasigurisë dhe një mundësi për të nxitur në mënyrë të efektshme aftësinë ripërtëritëse të ekosistemit. Kur menaxhohen shumica e ekosistemeve, ekziston një shkallë e pranishme e pasigurisë, për shkak të natyrës së tyre komplekse, dinamike dhe vetëorganizuese. Kjo gjithashtu nënkupton se ekosistemet kanë aftësi më të mëdha ripërtëritëse, e cila ofron një sërë mundësish për të reaguar ndaj ngjarjeve të përsheptuara shoqërore, ekonomike apo klimatike.</p> <p>Baza e menaxhimit të përshtatur bazohet në fakte të ofruara nga monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm, duke u përqendruar në dijet shkencore si dhe njohuritë autoktone, tradicionale dhe lokale. Përmes miratimit proaktiv të një qasjeje të menaxhimit të përshtatur, ZMN-të mund të vazhdojnë të jenë pjesë e të gjithë kohëzgjatjes së ndërhyrjes dhe të arrijnë të minimizojnë rrezikun e dështimit apo investimeve të papërshtatshme.</p>	<p>7.1 Strategjia e ZMN-ve krijohet dhe përdoret si bazë për monitorimin e vazhdueshëm dhe vlerësimin e ndërhyrjes</p> <p>Udhëzues: Strategjia e ZMN-ve, në formën e saj më të thjeshtë, përfshin arsyetimin për ZMN-të, formulimin e saktë të rezultateve të synuara dhe kuptimin e qartë të realizimit të tyre përmes veprimeve të ndërmarra. Ajo duhet të informohet nga kushtet mbizotëruese ekonomike, shoqërore dhe ekologjike, dhe të shprehë në mënyrë të qartë supozimet nëse dhe si ato do të ndryshojnë.</p>
	<p>7.2 Plani i monitorimit dhe vlerësimit zhvillohet dhe zbatohet gjatë kohëzgjatjes së ndërhyrjes</p> <p>Udhëzim: Plani i monitorimit dhe vlerësimit është kërkesa kryesore për të kuptuar nëse strategjia e ZMN-së ka realizuar me efikasitet rezultatet dhe, për rrjedhojë ka arritur të adresojë sfidën shoqërore; dhe, nëse rreziqet apo ndikimet e papritura nënkuptojnë ndryshim në strategji apo kërkohet veprim. Aty ku ZMN-ja ka sinergji me ndërhyrje apo qasje të tjera, këto duhet të përfshihen në planin e monitorimit dhe vlerësimit (M&V). Devijimet e vëzhguara dhe të pandryshuara nga elementët kryesorë të strategjisë së ZMN-ve (7.1) duhet të shkaktojnë reagim për menaxhimin e përshtatur (7.3).</p>
	<p>7.3 Korniza për të nxënë të ripërsëritës e cila bën të mundur zbatimin e menaxhimit të përshtatur zbatohet gjatë gjithë kohëzgjatjes së ndërhyrjes</p> <p>Udhëzim: Të nxënë të bazuar në fakte duhet të drejtojnë menaxhimin e ZMN-ve. Për më tepër, të nxënë të ripërsëritës është thelbësor për informimin e veprimeve të menaxhimit të përshtatur, në mënyrë që të reagojë ndaj faktorëve të cilët ndikojnë në ndërhyrjet e ZMN-ve. Për këtë Kriter, treguesit 7.1 dhe 7.2 sigurojnë një qark të reagimit (feedback loop) për të mësuar dhe përshtatur ndërhyrjen e ZMN-ve. Mënyra më e mirë për vijimësinë e të nxënit ripërsëritës është institucionalizimi i tij, edhe pasi të ketë përfunduar ndërhyrja e ZMN-së.</p>

Menaxhimi i përshtatur




Figura 16 Menaxhimi i përshtatur i bazuar në fakte mund të rrisë shumë mundësitë e zbatimit të suksesshëm dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të zgjidhjes. Planifikimi dhe të nxënëti nga një bazë e fortë sipas qasjes së menaxhimit të përshtatur. © IUCN



Figura 17 Qetë duke pliguar tokat e degraduara për restaurimin dhe mbjelljen, Shinianga © Edmund Barrow

Rast studimor: Shinianga

Shinianga, në veriperëndim të Tanzanisë dhe në jug të Liqenit Viktoria, mbështet mbi 2.25 milionë njerëz në një zonë prej vetëm 50,000 km². Densiteti i lartë i popullsisë ka shkaktuar probleme serioze të tokave duke i degraduar dhe duke i kthyer në toka djerrë. Iniciativa kombëtare e restaurimit (HASHI) filloi në vitin 1985 duke përfshirë mbjelljen e pemëve ekzotike. Mbi 1 milionë fidanë ekzotikë nga një fidanishte e vetme e përqendruar vetëm në prodhimin e pemëve, u shpërndanë në pothuaj 700 fshatra. Megjithatë, kjo nuk pati shumë sukses në disa pjesë, për shkak të mungesës së përvetësimit të projektit nga fshatarët. Përmes menaxhimit të përshtatur, u ndërmor një qasje më gjithëpërfshirëse, një zgjedhje e rëndësishme për suksesin afatgjatë. Fshatarët e zonës nuk donin “pemë HASHI” por pemët e tyre (kryesisht specie autoktone). Qasjet me prirje hierarkike dështuan, meqenëse HASHI nuk përfshinte punonjësit e pushtetit vendor dhe institucionet e tyre. Prioritetet e reja u bënë ngritja e kapaciteteve vendore të fshatarëve dhe puna me njerëzit dhe institucionet

tradicionale për të rihartuar përpjekjet për restaurimin. Për restaurimin e suksesshëm të pyjeve u bashkuan përbërësit e duhur duke respektuar institucionet formale dhe joformale vendore. Rreth vitit 2004, mbi 300,000 ha u restauruan, me vlerën prej 14 dollarë amerikanë për banor në muaj. Pothuajse çdo familje kishte zonë të restauruar. Njerëzve pa tokë dhe familjeve me kryefamiljare femra iu dha tokë, dhe kështu grupe dhe fshatra të tëra kishin zonë më të mëdha të restauruar. HASHI përdori qasjen pionere gjithëpërfshirëse për të zëvendësuar proceset hierarkike. Nga një fidanishte e menaxhuar nga pushteti qendror më 1986 dhe një rajon i quajtur “shkretëtira” e Tanzanisë, tanimë ajo zonë numëron mbi 1,000 fidanishte të vogla komunitare dhe individuale të krijuara deri në vitin 2004 me mbi 300,000 ha pyje të restauruar. Për më tepër, HASHI ishte një proces i cili filloi si një projekt, u bë një program dhe më tej një lëvizje që nga viti 1986 deri në ditët e sotme (35 vjet) duke ruajtur ndikimin përmes reagimeve të menaxhimit të përshtatur.⁷

7 Barrow, E. (2014). 300, 000 Hektarë të restauruara në Shinianga, Tanzani - por çfarë u desh për të arritur këtë restaurim. SAPIENS 7(2). <https://journals.openedition.org/sapiens/1542>

Kriteri 8: ZMN-të janë të qëndrueshme dhe të integruara brenda kontekstit të duhur territorial

Udhëzimi:	Treguesit
<p>Ky Kriter kërkon që ndërhyrjet e ZMN-ve të hartohen dhe menaxhohen me idenë e qëndrueshmërisë afatgjatë dhe të bëhen pjesë e përgjegjësisë, punës dhe harmonizimit të kornizave sektoriale, kombëtare dhe të politikave të tjera.</p> <p>Për të integruar ZMN-të ekzistojnë qasje të ndryshme: megjithatë, të gjitha mbështeten në komunikime dhe përfshirje strategjike. Publiku i synuar përfshin individët (p.sh. publikun e gjerë, akademikët), institucionet (p.sh. pushtetin qendror, bizneset e sapokrijuara, bizneset, dhe organizatat) dhe rrjetet globale (p.sh. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Marrëveshjen e Parisit).</p>	<p>8.1 Hartimi i ZMN-ve, zbatimi dhe mësimet e nxjerra ndahen për të sjellë ndryshime transformuese</p> <p>Udhëzim: Ndryshimi transformues mund të karakterizohet duke u shkallëzuar (integrimi i politikës apo programit), zgjeruar (zgjerim në nivelin gjeografik apo sektorial) apo replikuar ZMN-të. Për rrjedhojë, është e rëndësishme të përvetësohet procesi i hartimit dhe zbatimit, të dokumentohen dhe të vihen në dispozicion të individëve dhe aktorëve mësimet e nxjerra gjatë procesit të replikimit. Kjo përfshin vendimmarrësit, investuesit dhe përdorues të tjerë të ZMN-ve nga sektorët publikë dhe privatë.</p>
	<p>8.2 ZMN-ja informon dhe rrit politikën lehtësuese dhe kuadrin rregullator për të mbështetur përdorimin dhe integrimin e saj</p> <p>Udhëzim: Zbatimi i ZMN-ve i nënshtrohet një sërë politikave, ligjeve dhe rregulloreve sektoriale të mëparshme, disa prej të cilave mund të mos jenë të përshtatshme apo përforcuese. Në disa situata, politikën dhe rregulloret e papërshtatshme mund të kufizojnë prezantimin e duhur të ZMN-së, ose në rastin më të keq, kontribuojnë në humbjen e funksioneve të rëndësishme të ekosistemit përgjatë periudhës kohore. Në situata të tilla, është e rëndësishme të: a) jemi të vetëdijshëm për politikën, dispozitat rregullatore dhe ligjore dhe b) punojmë me vendimmarrës të nivelit vendor dhe/ose qendror si dhe me aktorë të tjerë kryesorë, për të identifikuar pengesa të tilla dhe për të përcaktuar reagimet e efektshme apo zgjidhje të tjera të mundshme.</p>
	<p>8.3 Në rastet përkatëse, ZMN-ja kontribuon ndaj objektivave kombëtare dhe globale për mirëqenien e njeriut, ndryshimet klimatike, biodiversitetin dhe të drejtat e njeriut, duke përfshirë Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Popujve Autoktonë (UNDRIP)</p> <p>Udhëzim: ZMN-të mund të kontribuojnë dukshëm ndaj objektivave ekonomike, shoqërore dhe të ruajtjes dhe ndihmojnë për realizimin e angazhimeve kombëtare në proceset ndërkombëtare për ndryshimet klimatike, të drejtat e njeriut, zhvillimin e njeriut dhe biodiversitetin. Qartësimi i këtyre lidhjeve, dokumentimi dhe komunikimi i tyre, ndihmon për të përforcuar më tej profilin dhe rolin e ZMN-ve në shkallë kombëtare, siguron angazhimin e qëndrueshëm politik në shkallë të gjerë, si dhe ofron mbështetje shoqërore, duke përforcuar në këtë mënyrë qëndrueshmërinë afatgjatë të ndërhyrjes.</p>

Integrim dhe qëndrueshmëri



Figura 18 Qëndrueshmëria e një zgjidhjeje rritet dukshëm kur ajo siguron kontribute konkrete ndaj angazhimeve kombëtare dhe globale të tilla si OZHQ (SDGs) © UN



Figura 19 Ripyllëzimi i mangroveve-rizoforeve në basenin e lumit Paz të El Salvadorit. Banorët e zonës varen nga ligatinat dhe mangrovet-rizofore për peshkimin, drurin për ngrohje dhe lëndën drusore. © Orsibal Ramirez/IUCN.

Rast studimor: Sfida e Bonn-it të El Salvadorit

El Salvadori ka marrë përsipër restaurimin e 1 milionë hektarë tokë deri më 2030, përmes angazhimit të Sfidës së Bonn-it. Në Dhjetor 2018 ka filluar të restaurohet një sipërfaqe totale prej 122,093 hektarësh në bazë të 277 projekteve të restaurimit, duke përdorur qasjen e Restaurimit të Peizazhit Pyjor (RPP). Përfitimet që shoqërohen me këtë nismë përfshijnë krijimin e vendeve të punës në mënyrë direkte apo indirekte, reduktimin e emetimeve të përlogaritura me 3,647,060 tCO₂e, dhe reastaurimin e përafërsisht 32,812 hektarëve në zonat e mbrojtura apo zonat kryesore të biodiversitetit (ZKB), si përpjekje për të shmangur humbjen e biodiversitetit. RPP siguron një kontribut të drejtpërdrejtë

në 10 politika kombëtare, plane dhe strategji të El Salvadorit dhe veprimet kryhen përmes Programit Kombëtar të Ekosistemit dhe Peizazhit, i cili kërkon sinergji ndërmjet 10 politikave, etj. për të mobilizuar veprimin mbi bazë shkalle (në kohë dhe hapësirë). Ente të tilla si Kabineti për Qëndrueshmërinë dhe Cënueshmërinë Mjedisore si dhe Këshilli Kombëtar për Qëndrueshmërinë dhe Cënueshmërinë Mjedisore shërbejnë si mekanizma për bashkërendimin, të nxënë, menaxhimin e përshtatur dhe më së shumti për institucionalizimin e RPP si ZMN për ndikimet e ndryshimeve klimatike ndaj PKVVK (Planit Kombëtar të Veprimit për Ndryshimet Klimatike).⁸

8 Dave, R., Saint-Laurent, C., Murray, L., Antunes Daldegan, G., Brower, R., de Mattos Scaramuzza, C.A., Raes, L., Simonit, S., Catapan, M., García Contreras, G. et al. (2019). Second Bonn Challenge progres report. Application of the Barometer in 2018 (Raporti i dytë i progresit për Sfidën e Bonn-it. Zbatimi i Barometrit më 2018). Gland, Switzerland, IUCN. <https://doi.org/10.2305/IUCN.CH.2019.06.en>



UNIONIT NDËRKOMBËTAR PËR
RUAJTJEN E NATYRËS

SELIA BOTËRORE
Rue Mauverney 28
1196 Gland, Switzerland
Tel +41 22 999 0000
Fax +41 22 999 0002
NbSStandard@iucn.org
www.iucn.org